

FJALA E DEPUTETES ENSLEMVERA ZAKE

E PREMTE 28 TETOR 2022

Do të sqaroj diçka, duke iu referuar pyetjes që bëri zonja Tabaku, në lidhje me planin e realizimit të buxhetit që ka qenë në masën 67% dhe si ka mundësi që në raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit është realizuar fakti 97%. Në planin 67% nuk është përfshirë fondi i rindërtimit. Në bazë të treguesve fiskalë që na ka vendosur në dispozicion Ministria e Financave fondi për rindërtimin i realizuar në vitin 2021 ka qenë 19,9 miliardë, pra gati 20 miliardë.

Pra, te plani 67% i buxhetit i është shtuar edhe fondi i rindërtimit, që është bërë me VKM, i alokuara gjatë vitit 2021 dhe është realizuar 97%. Edhe diçka në lidhje me pushtetin vendor, numrin e punonjësve të zonjës Koliqi, ashtu siç theksoi edhe ministrja e Financave, pushteti vendor është i pavarur dhe numrin e punonjësve e miratojnë me vendim të këshillit bashkiak dhe nuk kanë detyrim ligjor për të referuar tabelat, të cilat kërkon ministrja e Financave. Raportojnë, por numrin e punonjësve e miratojnë vetë në mënyrë të pavarur. Faleminderit!